REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2152/2 **Prot.** **Tiranë, më** 30.10 **2026**

VENDIM
Nr. 136 **datë** 30.10 **2026**
PËR
NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME UNIVERSITETIN SHTETËROR TË SAMARKANDËS "SHAROF RASHIDOVIT", UZBEKISTAN

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma "c" dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 20, pika "s" të Statutit të Universitetin të Sporteve të Tiranës si dhe në **Vendimin e Rektoratit nr. 124** datë **27/10/2026**, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës **30/10/2026**,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet **Universitetit të Sporteve të Tiranës** dhe **Universitetit Shtetëror të Samarkandës "Sharof Rashidovit", Uzbekistan.**

2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.

3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha proçedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I SPORTEVE - TIRANË